



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2022:009199

Datë: 04.04.2024

Numri i dokumentit: 05542681

**P.nr./..**

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, DIVIZIONI PENAL** gjyqtari i vetëm gjykues Musë Povataj, me pjesëmarrje të bashkëpunëtores profesionale Edona Berisha Kastrati, në çështjen penale ndaj të pandehurit Sh.. A., për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par 1 lidhur me par 1.4 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë Departamenti i Përgjithshme PP/II-nr.2484/21 të datës 18.01.2022, jashtë seancës gjyqësore me datë 04.04.2024 bie këtë:

**A K T V E N D I M**

**I. APROVOHET** marrëveshja për ndërmjetësim Nd.nr./.. e datës ..... e lidhur në mesë të pandehurit Sh.. A. dhe të dëmtuarit S... M... B... nga fsh L... K.. P...

**II. HUDHET** aktakuza e Prokurorisë Themelore ne Pejë Departamenti i Përgjithshëm PP/II-nr.2484/21 të datës 18.01.2022.

**III. PUSHOHET** procedura penale ndaj të pandehurit: **SH.. A..**, i lindur me dt. ... në fshatin L.. K.. P., ku edhe banon, i biri i S.. dhe nënës Gj.. e vajzërisë G.., i martuar, ka të kryer shkollën fillore, i identifikuar në bazë të letërnjoftimit me numër personal ....., i nacionalitetit Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

- për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par. 1 nen par 1.4 të KPRK-së.

**A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamentit të Përgjithshme me datën 18.01.2022 ka ngritur aktakuzën PP/II.nr.2484/22 ndaj të pandehurit Sh.. A.. për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par 1 lidhur me par 1.4 të KPRK-së.

Me datën 29.03.2024 është arrit marrëveshja në zyrën e ndërmjetësimit në mes të pandehurit Sh.. A.. dhe të dëmtuarit S.. M.. B.. nga fsh. L.. K.. P.., e cila marrëveshje i është dozuar gjykatës në kopje të mjaftueshme.

Nga të cekurat më lartë gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi duke e pranuar marrëveshja për ndërmjetësim Nd.nr.382/24 e datës 29.03.2024 e lidhur në mesë të pandehurit Sh.. A.. dhe të dëmtuarit S.. .. M.. B.. nga fsh. L.. K.. P..

Me dispozitën ligjore të nenin 229 par. 5 të KPRK-së është përcaktuar se: nëse aktakuza është dorëzuar, gjyqtari i vetëm gjykues, nëse e pranon formalisht marrëveshjen, merr vendim për të hedhur aktakuzën dhe e ndërprejë procedurën penale.

Andaj nga të cekurat më lartë e në kuptim 229 par.5 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE PEJË – DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM ,  
DIVIZIONI PENAL  
2022:009199, 04.04.2024**

**Bashkëpunëtorja Profesionale**

**Gj y q t a r i**

Edona Berisha Kastrati

Musë Povataj

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë të parashtrojnë ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë përmes kësaj Gjykate, në afat prej 3 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtit.